

ARJANA FULLANI, Anëtare e Gjykatës së Lartë, ka lindur në Tiranë më 03 Shtator 1965. Është e martuar dhe ka dy fëmijë. Është diplomuar për drejtësi në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë në vitin 1987 me rezultate të shkëlqyera dhe në 2007 ka marrë titullin Master i Ligjeve (LLM).

Znj. Fullani ka ushtruar funksionin e Prokurores pranë sektorit të Prokurorisë së Rrethit Tiranë në vitet 1987-1992, ndërsa nga viti 1992 deri me 1994 është emëruar Gjyqtare pranë Gjykates së Rrethit Tiranë. Nga viti 1994 deri me 1995 është emëruar Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Në periudhën 1995-1997 ka qënë Drejtore e Shkollës së Magjistraturës. Znj. Fullani ka qënë këshilltare pranë Gjykatës së Kasacionit në vitin 1997 dhe në periudhën 1997 deri ne 2000 ka themeluar dhe drejtuar Qendrën Avokatore për Gra. Nga viti 2000 deri me 2008 ka ushtruar funksionin e Drejtores së Shkollës së Magjistraturës. Znj. Fullani ka qënë pedagoge me kohë të pjesshme pranë Fakultetit të Drejtësisë në lëndët “E Drejta Civile” dhe “Procedura Civile”, si dhe pedagoge me kohë të pjesshme pranë Shkollës së Magjistraturës. Ajo ka marrë pjesë në një sërë konferencash e trajnimesh, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fusha të ndryshme të së drejtës, si edhe në takime rajonale dhe Evropiane të qendrave të trajnimit për gjyqtarë.

Që në fillim të viteve 90 e në vazhdim ka qënë themeluese dhe/ose anëtare bordi në një sërë organizatash joqeveritare, si: Qendra Avokatore për Gra, Refleksione, Fondacioni Soros, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Komiteti Shqiptar i Etikës Mjekësore, Shoqata Ndërkombëtare e Gjyqtareve Gra, etj. Nga viti 2003-2008 znj. Fullani ka qënë anëtare e Komisionit të Reformës Ligjore, si dhe anëtare e grupeve të punës për hartimin dhe diskutimin e ligjeve të ndryshme.